

DEKRET
Nr.1700, datë 9.1.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", në fund të nenit 2 shtohet paragrafi:

"- taksë për importimin e automjeteve të përdorura".

Neni 2

Pas nënpikës N të pikës "Për taksat nacionale", të nenit 7, shtohet:

"Nj. Taksë për importimin e automjeteve të përdorura caktohet:

- Për autovetura dhe kamionë deri në 3 tonë caktohet 60 000 lekë.

- Për kamionë mbi 3 tonë dhe autobuzë caktohet 100 000 lekë".

Neni 3

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

Pas nënpikës "m" të pikës "Për taksat nacionale" shtohet:

"n) Për taksën për importimin e automjeteve të përdorura 0%"

Pas nënpikës "1" të pikës "Për taksat nacionale" shtohet:

"m) Për vjeljen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave".

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi më 10.1.1997.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha